



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË -AUTORITETI I KONKURRENCËS-

---

### Njoftim për shtyp

#### Mbi rregulloren e re të Lehtësimit nga Gjobat

Në kuadër të përafritimit dhe plotësimit të legjislacionit me atë të Bashkimit European si dhe rritjes së bashkëpunimit me aktorët e tregut, Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e fundit miratori rregulloren e re “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”. Me miratimin e kësaj rregulloreje, Autoriteti i Konkurrencës, mundëson zbatimin e një programi të ri dhe efikas, të lehtësimit nga gjobat për bizneset që bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës, në zbulimin dhe ndalimin e praktikave anti-konkurrese.

Nëpërmjet kësaj rregulloreje mundësohet rritja e transparencës ndaj publikut në përgjithësi dhe komunitetit të biznesit në veçanti. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i metodologjisë, me anë të së cilës, Autoriteti i Konkurrencës llogarit gjobat që vendosen ndaj ndërmarrjeve, të cilat shkelin Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe lehtësimin e tyre nga gjobat në rastet e bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës për identifikimin e marrëveshjeve të ndaluara.

Pjesa më e rëndësishme për biznesin në këtë rregullore është mundësia që ju jepet ndërmarrjeve për të përfituar heqjen e plotë ose të pjesshme të gjobës në rast se bashkëpunojnë me Autoritetin. Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe rregullores së sapohyrë në fuqi, të gjitha ndërmarrjet këshillohen nga ana e Komisionit për mundësinë e përfitimit të lehtësimit nga gjoba nëse bashkëpunon me Autoritetit sipas parashikimeve të Ligjit dhe kësaj rregulloreje..

Komisioni i konkurrencës nxit biznesin për bashkëpunim, pasi funksionimi i këtij institucioni të pavaruar publik është në interes të bizneseve që respektojnë lojën e rregullt të tregut dhe e konsiderojnë konkurrencën si nxitës të inovacionit dhe të rritjes së qëndrueshme. Sipas kësaj rregulloreje, Komisioni mund të japë lehtësim të plotë nga çdo gjobë, nëse një ndërmarrje është e para që ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së ndaluar (si rastet kartel), si dhe në përcaktimin e personave përgjegjës duke siguruar prova dhe të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti, që i mundësojnë këtij të fundit të fillojë një hetim në lidhje me një marrëveshje të ndaluar ose të zbulojë një shkelje në bazë të Ligjit.

Ndërmarrja që kërkon lehtësim të plotë nga gjobat, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë për t'u konsideruar e imunizuar plotësisht ose pjesërisht nga gjoba dhe autoriteti në bazë të ligjit ruan anonimatin e ankesës apo denoncimit të saj.

Me përfundimin e procedurave hetimore, Komisioni i Konkurrencës vlerëson imunitetin nga gjoba për ndërmarrjen/ndërmarrjet që bashkëpunojnë dhe vendosjen e gjobës për ndërmarrjet e tjera pjesëmarrëse në kartel, gjoba që në bazë të nenit 74 të Ligjit janë të përcaktuar nga 2-10 % të xhiros vjetore, një shifër e konsiderueshme kjo, për tu marrë në konsideratë nga ndërmarrjet që marrin pjesë në marrëveshje të ndaluara.